



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.201/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Zenel Leku dhe Milena Gjeriq anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Z. B. nga fshati ..., Komuna e Sh., të cilin e përfaqëson me autorizim Avokati Xhemajl Ahmeti nga F., kundër të paditurve Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Drejtësisë, në Prishtinë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me autorizim B. M., Jurist i Diplomuar, për shkak të kompensimit të kamatës dhe fitimit të humbur, përkitazi me revizionin e të paditurit të dytë, (KGJK) paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.10318/2021 datë 16.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 20.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pathemeltë revizioni i të paditurit Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.10318/2021 dt.16.02.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.10318/2021 dt.16.02.2024, refuzohen si të pa themelta ankesat e paditësit dhe të paditurit të dytë, dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2352/14 dt.22.09.2021, në pikën I, II, dhe IV (pika III e dispozitivit të tij, mbetet e pa shqyrtuar), me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe detyrohet i padituri i dytë (KGJK), që paditësit për mbajtjen e të hollave të sekuestruara në vlerë prej 16,755.00 euro, për periudhën prej dt.1.06.2000 deri 23.07.2014, t'ia kompensojë vlerat si në vijim: për periudhën nga dt.1.06.2000 deri më dt.20.12.2012, në emër të kamatës ligjore si për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit, pa destinim të caktuar, shumën prej 8,613.78 euro, ndërsa, në emër të kamatës prej 8% për

periudhën nga dt.21.12.2012 deri më dt.23.07.2014, shumën prej 2,129.95 euro, të gjitha së bashku në vlerë të përgjithshme prej 10,743.73 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit ndaj të paditurit të dytë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri i dytë (KGJK) që në emër të fitimit të humbur për periudhën deri në nxjerrjen e ekspertizës t'ia kompensojë vlerën prej 41,309.20 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, si e pa bazuar. Me pjesën e III të dispozitivit të tij, refuzohet kërkesëpadia e paditësit kundër të paditurës së parë Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Drejtësisë, në Prishtinë, si e pa bazuar dhe me pjesën e IV të dispozitivit të tij, detyrohet i padituri i dytë (KGJK) që paditësit në emër të shpenzimeve gjyqësore t'ia paguajë shumën prej 1,995.20 euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor, ka paraqitur revizion i padituri i dytë (KGJK), për shkak të, siç thuhet në të, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale, jo në mënyrë të specifikuar (duke përfshirë në të, edhe pretendime rreth gjendjes faktike), me propozim që nga Gjykata Supreme e Kosovës të aprovohet revizioni si i bazuar, ashtu që aktgjykimet e instancave më të ulëta gjyqësore t'i prish dhe çështjen ta kthejë në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë apo të merr aktgjykim ndryshues dhe të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar në raport me të paditurin e dytë KGJK-në.

Përgjigje në revizion ka paraqitur paditësi nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit, me propozim që i njëjti të hedhet si i palejuar apo të refuzohet si i pa themeltë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të revizionit dhe aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 215 të LPK, gjeti se:

Revizioni i të paditurit të dytë (KGJK) është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, kundër të paditurve, më datën 28.08.2014, në gjykatën e shkallës së parë, ka parashtruar padi me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurit, që paditësit, në emër të kompensimit të dëmit përkatës, t'i paguajnë shumat si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht, me të dhëna tjera si në petitumin e padisë, përkatësisht si në precizimin e saj. Gjykata e shkallës së parë, nga provat e administruara ka gjetur

se është fakt i pa kontestuar se paditësit pas kontrollimit të shtëpisë së tij nga Policia i ishin marrë shuma prej 32.770.00 DM. Gjithashtu, nuk ishte kontestuese se i njëjti pas zhvillimit të procedurës penale ndaj tij, ishte shpallur i pa fajshëm, me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr.253/2007 dt.19.01.2011, i plotfuqishëm nga data 3.04.2014. Po ashtu, nuk ishte kontestues as fakti se më dt.23.07.2014, Policia e Kosovës, duke vepruar sipas urdhëresës së Gjykatës Themelore në Prishtinë i kishte kthyer shumën prej 16,755.00 euro, si kundërvlerë e të hollave që iu kishin marrë, të konvertuara në euro, të cilat atij, paditësit, i janë mbajtur të sekuestruara në kohëzgjatje prej 14 vitesh. Më tej, ka konstatuar se midis palëve ndërgjyqëse, është lidhur Ujdia – Barazimi jashtëgjyqësor, sipas të cilit paditësit (i cili kishte qëndruar në paraburgim për 334 ditë), i është kompensuar shuma e përgjithshme e dëmit prej 4,678.00 euro, e që përfshinte kompensimin e dëmit material (fitimin e humbur) dhe jo material (moral), e cila ujdji kishte të bëjë me kompensimin e dëmit për shkak të privimit të kundërligjshëm nga liria dhe jo me paratë e sekuestruara, përkatësisht, me të dhënat tjera, si në ujdjinë e sipër cekur të dt.4.06.2014, e cila gjendet në shkresat e lëndës. Nga ekspertiza financiare e ekspertit A. K., të dt.26.12.2018, e plotësuar më dt.2.06.2021, ka konstatuar se nëse merret parasysh llogaritja e kamatës për depozitat mbi një vit pa destinim të caktuar, vlera e kamatës për periudhën prej datës 1.06.2000 deri më 20.12.2012, arrin shumën prej 8,613.78 euro, ndërsa, vlera e kamatës për periudhën prej dt.21.12.2012 deri 23.07.2014, arrin vlerën prej 2,129.95 euro, të gjitha këto në vlerë të përgjithshme prej 10,743.73 euro, ndërsa, fitimi i humbur, po të punonte ai në sektorin e ndërtimtarisë, për periudhën e lartë cekur, do të ishte 41,309.20 euro, me të dhënat tjera të detajuara si në ekspertizën përkatëse.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe në mbështetje të dispozitave të nenit 154, nenit 155, nenit 185 etj, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, të njëjtën e ka miratuar dhe ka vendosur si në pjesën I, II, III dhe IV të dispozitivit të aktgjyimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore, ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, pasi që në tërësi ka aprovuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se e njëjta gjykatë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, ndaj, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjyimit të saj.

Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes juridiko civile, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Dispozitivi i aktgjykimit është i çartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse në arsyetim janë dhënë arsyet e mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet e pretenduara të së drejtës materiale dhe procedurale (të cilat nuk janë në masë të duhur të specifikuara), nuk mund t'i vejnë në pyetje aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së dytë dhe ajo e shkallës së parë, kanë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e së drejtës materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe nga arsyet e sipër përmendura, kanë obliguar të paditurën e dytë (KGJK), që atij t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar, në mënyrën dhe periudhën e sipër cekur, në lartësinë e shumës e cila është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, nga administrimi i provave si ekspertizat përkatëse, dhe me prova tjera materiale dhe shkresore që gjenden në dosjen e kësaj lënde dhe si në pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë gjendje të çështjes civilo-juridike, duhet theksuar se me dispozitën e nenit 154 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, parashihet se; ” kush i shkakton dëm tjetrit ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij ”. Në rastin konkret, pala paditëse ka arritur që të provojë, se e paditura e dytë, në mënyrën e përshkruar më lartë, asaj i ka shkaktuar dëmin, si më lartë, dhe se e njëjta është përgjegjëse për kompensimin e tij, ndaj, nga këtu, edhe kjo gjykatë, vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët, në mbështetje edhe të dispozitave të nenit 154, nenit 155, nenit 185 të LMD-së, drejtë e kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe në këtë drejtim, vendimi i tyre është i drejtë dhe i ligjshëm. Kështu sepse, kjo Gjykatë vlerëson se, në rastin konkret, janë plotësuar të gjitha parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit nga e paditura, siç janë ekzistimi i subjekteve të marrëdhënies detyrimore dhe të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, i dëmtuari dhe shkaktuesi i dëmit, fakti dëmtues nga rezulton dëmi, ekzistimi i dëmit të shkaktuar, lidhja shkakësore, etj, të cilat janë përmbushur kumulativisht, ndaj, nga këtu edhe përgjegjësia e të paditurës së dytë, për kompensimin e dëmit të lartë përmendur paditësit. Gjithashtu, veç tjerash,

edhe me dispozitat e nenit 185 të po të njëjtit ligj, parashihet se personi përgjegjës është i obliguar që të rivendos gjendjen e cila ka ekzistuar para se të ndodh dëmi, përkatësisht, nëse rivendosja e gjendjes së mëparshme, nuk eviton dëmin në tërësi, ose nuk është e mundur rivendosja e gjendjes së mëparshme, personi përgjegjës është i obliguar që për dëmin e mbetur të jep kompensimin në të holla, respektivisht, gjykata e cakton se ai do ti paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse të hollave në emër të kompensimit të dëmit, siç edhe është vepruar nga gjykata e instancës më të ulët.

Në kontekstin e mësipërm, duhet theksuar se edhe me nenin 155 të LMD-së, dëmi nënkupton; zvogëlimin e pasurisë (dëmi i zakonshëm), pengimin e rritjes së pasurisë, si dhe shkaktimin e dhimbjeve fizike dhe psikike apo të frikës tjetrit (dëmi jo material), sikundër edhe është rasti konkret i sipër përmendur, ndërkohë që, kamata në formën e dëmit material, është caktuar në kuptim të nenit 277 të LMD-së (1978), përkatësisht, nenit 382 të LMD-së(2012).

Po ashtu, për sa i përket disa pretendimeve të revizionit (faqe 2 dhe 3), përkitazi me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, duhet theksuar se me dispozitën e nenit 214.2 të LPK-së, “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike”.

Nga arsyet e sipër theksuara, e në mbështetje të nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.201/2024 datë 20.05.2024

Kryetari kolegjit

Mr.Sc.Muhamet Rexha